

SHOQËRIA “URBIS” SH.P.K
REGJISTRUAR SI SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ME NUIS M11315006J

VENDIM NR. 2 DATË 01. 11.2021





I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TË ORTAKËVE

Në mbledhjen e sotme, Asambleja e Jashtëzakonshme e Ortakëve të Shoqërisë “URBIS” shpk, bazuar në nenin 7 të Statutit dhe në nenin 80 të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar:

VENDOSI:

1. Anulimin tërësisht të kuotës prej 3% (tre për qind) në kapitalin e Shoqërisë “Urbis” sh.p.k në emër të ortakut Adil Maze bazuar në nenin 7, paragrafi 4 i Statutit të shoqërisë;
2. Shpërndarjen e kuotës së anuluar sipas paragrafit më lart, me nga një pikë përqindjeje për secilin nga tri ortakët e tjerë të shoqërisë “Urbis” shpk, duke rishpërndarë përqindjet e tri ortakëve si më poshtë:
 - a) Gentian Skënderaj, vlera e kuotës 34% (tridhjetë e katër për qind);
 - b) Helidon Begaj, 33% (tridhjetë e tre për qind);
 - c) Herodjan Terezi, 33% (tridhjetë e tre për qind).
3. Kalimin e peshës së votimit të ortakut Adil Maze prej 1% (një për qind) te ortaku Helidon Begaj në masën 0.5% (zero pikë pesë përqind), duke çuar peshën e votimit të ortakut Helidon Begaj në 24.5% (njëzet e katër pikë pesë përqind) dhe te ortaku Herodjan Elenko në masën 0.5% (zero pikë pesë përqind) duke çuar peshën e votimit të ortakut Herodjan Elenko në 24.5% (njëzet e katër pikë pesë përqind);
4. Zvogëlimin e kapitalit të regjistruar për shkak të anulimit të kuotës së ortakut Adil Maze, nga 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, në 145,500 (njëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) Euro.
5. Ndryshimin e Statutit të shoqërisë duke reflektuar katër pikat e mësipërme të këtij vendimi, sipas modelit bashkëngjitur.

ORTAKËT E PRANISHËM

Gentian Skënderaj	<u>Gentian Skënderaj</u> (PRO)	
Helidon Begaj	<u>Helidon Begaj</u> (PRO)	
Herodjan Terezi	<u>Herodjan Terezi</u> (PRO)	
Adil Maze	<u>Adil Maze</u> (PRO)	

NJOFTIMI I RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË ASAMBLESE SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË “URBIS” SHPK

Në Tiranë, sot më datë 20.10.2021, Z. Gentian Skënderaj, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Urbis” shpk, bazuar në nenin 14 të Statutit të shoqërisë dhe nenin 84 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, vendosi të njoftojë gjithë ortakët e shoqërisë për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të asamblesë së ortakëve, e cila do të mbahet në selinë e shoqërisë “Urbis” shpk, në Tiranë, Njesia Bashkiake nr. 5, rruga Ibrahim Rugova, shkall 1/1, ap. 22, më datë 01.11.2021, ora 10:30, me rend dite:

1. Anulimin tërësisht të kuotës prej 3% (tre për qind) në kapitalin e Shoqërisë “Urbis” sh.p.k në emër të ortakut Adil Maze bazuar në nenin 7, paragrafi 4 i Statutit të shoqërisë;
2. Shpërndarjen e kuotës së anuluar sipas paragrafit më lart, me nga një pikë përqindjeje për secilin nga tri ortakët e tjerë të shoqërisë “Urbis” shpk, duke rishpërndarë përqindjet e tri ortakëve si më poshtë:
 - a) Gentian Skënderaj, vlera e kuotës 34% (tridhjetë e katër për qind);
 - b) Helidon Begaj, 33% (tridhjetë e tre për qind);
 - c) Herodjan Terezi, 33% (tridhjetë e tre për qind).
3. Kalimin e peshës së votimit të ortakut Adil Maze prej 1% (një për qind) te ortaku Helidon Begaj në masën 0.5% (zero pikë pesë përqind), duke çuar peshën e votimit të ortakut Helidon Begaj në 24.5% (njëzet e katër pikë pesë përqind) dhe te ortaku Herodjan Elenko në masën 0.5% (zero pikë pesë përqind) duke çuar peshën e votimit të ortakut Herodjan Elenko në 24.5% (njëzet e katër pikë pesë përqind);
4. Zvogëlimin e kapitalit të regjistruar për shkak të anulimit të kuotës së ortakut Adil Maze, nga 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) Euro, në 145,500 (njëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind) Euro.
5. Ndryshimin e Statutit të shoqërisë duke reflektuar katër pikat e mësipërme të këtij vendimi, sipas modelit bashkëngjitur.

ADMINISTRATORI

Gentian Skënderaj

Gentian Skënderaj

